



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:191847
KA.nr.357/23
Datë: 18.09.2024
Numri i dokumentit: 06214480

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Grupi “Koha” me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Ardian Bajraktari avokat sipas autorizimit të datës 20.08.2024, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Leonora Sadiku Tupalla, me kërkesëpadi për anulim të vendimit me nr. 14-020/05-171446/23 të datës 18.08.2023 dhe vendimit me nr. 14-016/01-51462 të datës 22.04.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik më datë 12.09.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit me autorizim të palës paditëse dhe përfaqësuesit me autorizim të palës së paditur, më datë 18.09.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET në tërësi e bazuar** kërkesëpadija e paditësit “Grupi “Koha” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës me seli në Prishtinë
- II. **ANULOHET** vendimi me nr. 14-020/05-171446/23 të datës 18.08.2023 dhe vendimi me nr. 14-016/01-51462 të datës 22.04.2024, të nxjerra nga Kryetari i Komunës së Prishtinës, si të kundërligjshme.
- III. Mbetet në fuqi shtyrja e ekzekutimit të Vendimit me Nr. 14-020/05 – 171446/23 i datës 18.08.2023, i publikuar me datë 21.08.2023, deri në plotfuqishmërinë e këtij aktgjykimi.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Zhvillimi procedural dhe pretendimet e palëve

1. Më datë 28.03.2023 në Gjykatën Komerciale, Departamenti për Çështje Administrative, paditësi Grupi “Koha” me seli në Prishtinë ka parashtruar padi e kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, për shkak të anulimit të vendimit me nr. 14-020/05-171446/23 të datës 18.08.2023 me propozim që të aprovet si e bazuar kërkesëpadi dhe të anulohen vendimi i kundërshtuar.
2. Përfaqësuesi i paditësit në pretendimet e dhëna në padi, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se Kryetari i Komunës së Prishtinës përmes vendimit të datës 18.03.2023 të publikuar më datë 21.08.2023 ka vendosur për mbylljen për qarkullim të mjeteve motorike në tri rrugë të kryeqytetit, përfshirë rrugët/rrugicat të cilat kalojnë/të dërgojnë në parkun e Universitetit të Prishtinës dhe Bibliotekës Kombëtare, duke filluar nga data 01 Shtator 2023. Paditësi pretendon se ky vendim është marrë në shkelje të dispozitave të procedurës administrative konkretisht neneve 47 dhe 52 pasi që i njëjti nuk përmban as arsyetimin dhe as këshillën juridike.
3. Sipas tij, në oborrin e objektit ku e ushtron veprimtarinë paditësi është edhe parkingu i së njëjtës ku gazetarët, kameramanët dhe pjesa tjetër e stafit janë qasur në parking, ndërsa me mbylljen e kësaj rruge, të njëjtit nuk do të kenë mundësi qasjeje në këtë objekt. Ka shtuar se paditësi gjithçka ka kuptuar nga një postim i kryetarit të komunës ku ndër të tjerash thuhet se: “Interesi i përgjithshëm publik, siguria dhe shëndeti i qytetarëve mbi të gjitha. Ky vendim me qëllim të realizimit të planit regjenerues të hapësirave publike, në konsultim me Universitetin e Prishtinës dhe Bibliotekën Kombëtare pasi që këto pjesë janë duke u përdorur si parkingje dhe po bllokojnë shfrytëzimin e këtyre hapësirave publike”. Paditësi deklaron se nga ky publikim konsideron se konsultimi është zhvilluar me Universitetin e Prishtinës dhe Bibliotekën Kombëtare por jo është me Grupin “Koha tani paditës. Udhëzimi Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna ka përcaktuar obligimin e Komunave për zhvillimin e konsultimeve publike që nuk ka ndodhur në këtë rast.

4. Ka theksuar se vendimi i kundërshtuar nuk është aspak i domosdoshëm për të arritur qëllimin e caktuar sepse mbyllja për qarkullim e një rrugë ne tërësi nuk është aspak në proporcion dhe as e domosdoshme që të ndalohej parkingu për bllokimin e hapësirave publike dhe si vendim nuk është i ligjshëm për faktin se është në kundërshtim me nenin 5 të LPPA-së pasi që cenon një prej parimeve kryesor të përgjithshme të procedurës administrative atë të proporcionalitetit, pasi që kufizimi i hapësirave nuk është aspak i domosdoshëm për të arritur qëllimin e caktuar në rastin konkret. Përveç kësaj paditësi ka siguruar prova nga gjeo-portali i hapësirës përreth, të cilat deklarohen se janë prona në shfrytëzim të qytetarëve të cilat së paku në postimit publik të kryetarit të kryeqytetit nuk është thënë se janë konsultuar.
5. Përfaqësuesi i të paditurës në pretendimet e dhëna në përgjigje në padi sipas parashtresës së datës 28.08.2024 ka deklaruar se me vendimin me nr. 14-016/01-51462 të datës 22.04.2024 është shfuqizuar vendimi me nr. 14-020/05-171446/23 i datës 18.08.2023 vendim i cili sipas paditëses e ka penguar shfrytëzimin e parkingut dhe qarkullimin e veturave zyrtare të saj. Nga aktet administrative të cilat kundërshtohen nga paditësja nuk preken të drejtat e paditëses apo interesin e saj i drejtpërdrejtë bazuar në ligj. I ka propozuar gjykatës që të hedh poshtë padinë e paditëses konfirmo nenit 34.par.1 nën par. 1.3 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) .
6. Paditësi pas pranimit të vendimit me numër 14.016/01-51462 me datë 22.04.2024, e ka njoftuar gjykatën se ende ka interes për vazhdim të shqyrtimit të padisë meqenëse situata faktike nuk ka ndryshuar dhe edhe shfuqizimi i vendimit nuk e ka kthyer situatën në gjendjen e mëparshme. Për më tepër vendimi që shfuqizon vendimin kontestues shoqërohet me të meta të njëjta madje edhe përtej aktit kontestues. Ky akt është në kundërshtim me nenin 47 dhe 48 të LPPA-së, për faktin se i mungon elementi kyç arsyetimi, prandaj pala paditëse nuk i din arsyet e anulimit të aktit kontestues. Palës paditëse i është pamundësuar shfrytëzimin miqësor i pronës, prandaj e zgjeron padinë edhe në drejtim të aktin e ri respektivisht vendimin me numër 14-016/01-51462 të datës 22.04.2024 dhe i propozon gjykatës që të dy vendimet e kundërshtuara ti anulohet si të kundërligjshme.

Provat e administruara dhe vërtetimi i gjendjes faktike

7. Fillimisht, gjykata duke vepruar në bazë të Nenit 36 paragrafi 4 të LKA-së, ku përcaktohet *1. Nëse organi gjatë kohës së procedurës gjyqësore nxjerr aktin tjetër me të*

cilin revokohet ose shfuqizohet akti administrativ kundër të cilit është ngritur konflikti administrativ, [...] 2. Në këtë rast gjykata do ta ftojë paditësin që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh të deklarojë nëse me aktin administrativ të nxjerrë në afatin e mëvonshëm: 2.1. është i kënaqur; 2.2. nuk heq dorë nga padia; 4. Nëse paditësi deklaron se me aktin e ri nuk është ai/ajo i kënaqur, gjykata do ta vazhdojë procedurën, aprovoj propozimin e paditësit për zgjerimin e kërkesëpadisë dhe vazhdoj procedurën e shqyrtimit të akteve të kundërshtuara.

8. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, mbajti seancë të shqyrtimit kryesor më datë 22.08.2024 dhe më datë 12.09.2024 me pjesëmarrje të përfaqësuesve të autorizuar të palëve dhe administroj provat: Vendimi me nr. 14-020/05-171446/23 i datës 18.08.2023, Vendimi me nr. 14-016/01-51462 të datës 22.04.2024, Njoftimi i Kryetarit të Komunë së Kryeqytetit Përparim Rama, lidhur me vendimin për mbylljen e qarkullimit të mjeteve si në vendimin e kundërshtuar, provat e siguruara nga ana e paditësit të marra nga gjeo-portal në të cilat pasqyrohen pronat përreth hapësirës kontestuese. Nga provat e administruara vërtetohet këtë gjendje faktike:
9. Sipas Vendimit me nr. 14-020/05-171446/23 të datës 18.08.2023, Kryetari i Kryeqytetit Përparim Rama përmes këtij vendimi në pikën 1. Ka bërë mbylljen për qarkullim të mjeteve motorike në rrugën “Rexhep Luci” nga tuneli deri tek Sheshi, rrugën “Qamil Hoxha”, nga kthesa e rrugës e deri tek sheshi, dhe rrugët/rrugicat të cilat kalojnë/dërgojnë në Parkun e Universitetit të Prishtinës dhe Bibliotekës Kombëtare, e cila nënkupton ndalimin e qarkullimit për të gjitha mjetet motorike duke filluar nga data 01 Shtator 2023.
10. Nga Njoftimi i Kryetarit të Kryeqytetit Përparim Rama i datës 23.08.2023 lidhur me vendimin për mbylljen e qarkullimit të mjeteve si në vendimin e kundërshtuar, i njëjti në profilin zyrtar në rrjetin social “Facebook”, ka njoftuar se duke u bazuar në interesin e përgjithshëm publik, ka marr vendim për mbylljen e qarkullimit të mjeteve motorike në një pjesë të rrugëve “Rexhepi Luci” dhe “Qamil Hoxha”, si dhe në rrugët/rrugicat të cilat kalojnë nëpër Parkun e Universitetit të Prishtinës dhe Bibliotekës Kombëtare, vendim i cili është marrë me qëllim të realizimit të planit regjenerues të këtyre hapësirave publike në konsultim me Universitetin e Prishtinës dhe Bibliotekën Kombëtare pasi që këto pjesë janë duke u përdorur si parkingje dhe bllokojnë shfrytëzimin e këtyre

hapësirave publike nga të gjithë qytetarët. Ky vendim është marrë pasi që është funksionalizuar Parkingu Nëntokësor në Qendër i cili ka në dispozicion 624 vend parkime për vetura i cili parking është në afërsi të gjitha objekteve institucionale e afariste përreth ku të gjitha objektet përreth kanë alternativë të afërt të parkingut.

11. Sipas Vendimit me nr. 14-016/01-51462 të datës 22.04.2024, në pikën 1 është shfuqizuar vendimi me nr. 14-020/05-171446/23 i datës 18.08.2023 për mbylljen dhe qarkullimin e mjeteve motorike në rrugën “Rexhep Luci” në rrugën “Qamil Hoxha” dhe rrugët/rrugicat të cilat kalojnë/dërgojnë në Parkun e Universitetit të Prishtinës dhe Bibliotekës Kombëtare.

Vlerësimi i gjykatës

12. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenit 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit, kundërshtimet e të paditurës dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.
13. Gjykata shqyrtoj vendimin e kundërshtuar në kuptim të nenit 9 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LKA-së) i cili përcakton se: “Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.
14. Vendimi i kundërshtuar si akt administrativ i përgjithshëm, siç përcaktohet në Nenin 44 LKA-së, i cili përcakton kuptimin e aktit administrativ, konsiderohet se *1. Akti administrativ është çdo manifestim vullneti i një organi publik, që rregullon në mënyrë të njëanshme një marrëdhënie juridike konkrete të së drejtës administrative, me qëllim prodhimin e pasojave juridike, 1.3. përcakton statusin sipas të së drejtës administrative të një objekti (sendi) apo të përdorimit të tij nga publiku (në vijim: “akti administrativ in rem”)*, me të cilin ndalohet qarkullimi i mjeteve motorike në një pjesë të rrugëve “Rexhepi Luci” dhe “Qamil Hoxha”, si dhe në rrugët/rrugicat të cilat kalojnë nëpër Parkun e Universitetit të Prishtinës dhe Bibliotekës Kombëtare, preket interesi juridik i

paditësit, sepse me këtë vendim i pamundësohet shfrytëzimi paqësor i pronës, respektivisht i pamundësohet qasja në parkingun e objektit të pronës së tyre si qasje të vetme nga rruga “Xhorxh Bush”, në rrugët/rrugicat të cilat kalojnë në Parkun e Universitetit të Prishtinës dhe Bibliotekës Kombëtare, të cilin paditësi e shfrytëzon për realizimin e aktivitetit të rregullt afarist si medium për parkimin e veturave zyrtare.

15. Gjykata rikujton se mbrojtja e te drejtës pronësore është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Nenin 46 [E drejta e pronës është e garantuar] si dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndërsa ndërhyrja në të drejtën pronësore mund të bëhen vetëm për interes publik dhe në bazë të parimit të proporcionalitetit, sipas Nenit 5 të LPPA-së, nëse *2.1. është i domosdoshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj; 2.2. është i përshtatshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar në ligj, dhe 2.3. kufizimi apo cenimi i të drejtës apo interesit juridik nuk është në shpërpjesëtim me realizimin e qëllimit të ndjekur.*
16. Vendimi i kundërshtuar me nr. 14-020/05-171446/23 i datës 18.08.2023, me të cilin paditësi i kufizohet qasja në pronë është në kundërshtim me dispozitat ligjore Neni 47 të Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rregullat themelore të procedurës për hartimin e akteve administrative, dhe në kundërshtim me parimet themelore të procedurës së përgjithshme administrative, parime këto të riafirmuar edhe Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (LVL).
17. Neni 13 i LVL-së, përcakton kompetencën e Kryetarit të Komunës, “të nxjerrë urdhëresa dhe vendime brenda fushës së kompetencave të tij”, dhe Neni 17 përcakton kompetenca të plota dhe ekskluzive për Komunat, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuar në legjislacionin e zbatueshëm - të cilat gjykata vlerëson se nuk janë respektuar në rastin konkret, për faktin se vendimi i kundërshtuar është nxjerr pa konsultim publik në kundërshtim me Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna (i vlefshëm në kohën e nxjerrjes së vendimit, i shfuqizuar me Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë). Neni 14 i UA, ku përcaktohet 1. *Komuna varësisht nga lloji i projekt propozimit identifikon qytetarët dhe palët e interesuara të cilat mund të ndikohen nga politika e caktuar në mënyrë që t’i ftoj të marrin pjesë në procesin e konsultimit publik.*

18. Nga njoftimi i Kryetarit të Kryeqytetit me datë 23.08.2023 lidhur me vendimin për mbylljen e qarkullimit të mjeteve si në vendimin e kundërshtuar, në profilin zyrtar në rrjetin social “Facebook”, rezulton se e paditura ka realizuar konsultime vetëm me një grup të ngushtë të palëve të interesit (pra vetëm me Universitetin e Prishtinës dhe Bibliotekën Kombëtare), duke i trajtuar në mënyrë ta pabarabartë dhe diskriminuese palët e tjera me interes juridik në këtë rast paditësin Grupin “Koha”, interesi juridik i të cilës ndikohet me vendimin e kundërshtuar duke e përjashtuar kështu në mënyrë të kundërligjshme nga e drejta për ndikim në bërjen e politikave publike, në kundërshtim me Nenin 6 i LPPA-së ku përcakton 1. *Organi publik vepron në pajtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.*
19. Prandaj, gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar i nxjerrë pa konsultim publik është në kundërshtim me: Parimin e Ligjshmërisë që përcakton se procesi i konsultimit publik zhvillohet në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e përgjithshme të zbatueshme brenda kompetencave komunale; Parimin e proporcionalitetit (si në paragrafin 14); Parimin e Transparencës - që nënkupton një qasje të hapur të komunës për të garantuar se qytetarët dhe palët e interesuara janë të informuara dhe kanë qasje në të gjitha dokumentet në procesin e konsultimit publik dhe në gjuhët zyrtare; dhe Parimit të Barazisë dhe mos diskriminimit - në mënyrë që të gjitha palët e interesuara të kenë qasje të barabartë dhe jodiskriminuese në procesin e konsultimit publik, të përcaktuara në Nenin 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2018, dhe si i tillë wshtw i kundërligjshëm dhe duhet të anulohet.
20. Gjithashtu vendimi i kundërshtuar nr. 14-020/05-171446/23 të datës 18.08.2023, është në kundërshtim me Neni 47 të Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative që përcakton strukturën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar, sepse nuk përmban arsyetimin për faktet vendimtare që kanë ndikuar në marrjen e vendimin dhe përshkrimin e zhvillimit e procedurës, qoftë edhe arsyetimin apo bazën ligjore se pse nuk është zhvilluar konsultim publik me rastin e marrjes së vendimit. Neni 49 i LPPA-së, përcakton se arsyetimi nuk është i nevojshëm vetëm nëse: 1.1. përjashtohet shprehimisht me ligj; [...] ose 1.3. akti administrativ i nxjerrë, sipas detyrës zyrtare, nuk cenon të drejtat apo interesat juridike të ndonjë pale. Ndërsa, në rastin konkret me vendimin e kundërshtuar është cënuar interesi juridik i

shfrytëzimit të pronës në mënyrë paqësore nga paditësi, i cili përveç që nuk është përfshirë në konsultim publik nuk i është dhënë as arsyetim.

21. Sa i përket vendimit me nr. 14-016/01-51462 të datës 22.04.2024 me të cilin është shfuqizuar vendimi me nr. 14-020/05-171446/23 të datës 18.08.2023, duke marr parasysh pretendimet e paditësit se gjendja faktike nuk ka ndryshuar as pas shfuqizimit të vendimit të kundërshtuar dhe duke pasur parasysh se e paditura nuk e ka kundërshtuar fare këtë pretendim me ndonjë argument apo provë të besueshme, gjykata vlerëson se vendimi i të paditurës me nr. 14-016/01-51462 të datës 22.04.2024 - nuk ka se si të konsiderohet ndryshe përveç se një vendim fiktiv i organit administrativ që ka për qëllim vënien në lajthim të gjykatës me qëllim që të pamundëson shqyrtimi gjyqësor për vlerësimin e ligshmërisë së vendimit të kundërshtuar Nr. 14-020/05-171446/23 të datës 18.08.2023, e që përfundimisht përveç shkeljes së parimeve të theksuara më lartë rezulton se e paditura, në këtë rast Kryetari i Komunës së Prishtinës, në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi publike ndërmerr veprime manipuluese duke nxjerr akte administrative fiktive të cilat nuk i zbaton në gjendjen reale faktike. Si i tillw akti administrativ fiktiv wshtw i kundërligjshëm dhe nuk ka efekt juridik.
22. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Vendimi për shpenzime procedurale shpenzimet procedurale u more në bazë të nenit 63 të LKA-së

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.357/23, datë 18.09.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.